



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 para. 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (b), nenit 10 pika 1,5 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Vendimi 1020 i datës 02.06.2020, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

## K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

- **Pozita e punës: Zyrtar për Mbrojtje në Punë**
- **Numri i pozitave: 1 (një)**
- **Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi.**
- Në rast se kohëzgjatja e kontratës aktuale të punëtorit që pranohet është më pak se 1 vit, atëherë kohëzgjatja e kontratës sipas këtij konkursi është 1 vit me mundësi vazhdimi, nga dita e fillimit të punës.

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE  
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE  
"TRAFIKU URBAN" SH.A.  
PRISHTINË

Nr. 1021 dt. 02.06.20

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të zhvilloj strategjinë, politikat dhe procedurat e mbrojtjes në punës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të ndërmarrjes.
- Të siguroj që stafi i ka kuptuar drejt dhe të punësuarit janë në dijeni të standardeve të mbrojtjes në punës.
- Të vlerësoj rrezikun në punë.
- Të identifikojë fatkeqësitë e mundshme.
- Të përpilon dhe shpërndanë raporte dhe letra informuese në kuadër të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë trajnimin e stafit në lidhje me mbrojtjen në punë.
- Në aspekt të sigurisë së punëtorëve gjatë punës bën inspektim e të gjitha vend-punimeve e veçanërisht punët me materie të rrezikshme në aspekt të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe në aspektin e mbrojtjes nga zjarri për krijimin e kushteve të sigurta të punës sipas Ligjit për Mbrojtje në Punë dhe të jap rekomandime eventuale.
- Punëtori udhëzohet për rreziqet e mundshme gjatë punës me lende djegëse, shpërthyes, etj dhe urdhërohet të zbatojë masat për mbrojtje në punë.
- Zyrtaari i Sigurimit dhe i Mbrojtjes në Punë e bën planin e evakuimit në rast të rrezikut nga zjarri apo fatkeqësitë natyrore dhe merr masa deri sa të sigurohet se të gjithë punëtorët janë larguar nga objekti;
- Në harmoni me Rregulloren e Mbrojtjes nga Zjarri organizon sërvisimin e vazhdueshëm të aparateve të mbrojtjes nga zjarri.
- Përgatit informata dhe planifikon masat e mbrojtjes në punë së bashku me personat përgjegjës të sektorit përkatës dhe me shërbimin juridik;
- Merr pjesë në organizimin e trajnimit të punëtorëve lidhur me mbrojtjen në punë dhe për këtë mbanë evidencë.
- Merr pjesë në organizimin e kontrollit periodik të mjeteve të punës dhe pajisjeve dhe të kushteve të punës, ku lidhur me këtë mbanë evidencë.

1

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



- Kryen punë të mbrojtjes preventive (para fillimit të punëve), informon lidhur me aplikimin e masave të mbrojtjes në punë, në bashkëpunim me departamentet tjera të TU ndikon që të zbatohen masat e mbrojtjes në punë në procesin e punës, pajisjet dhe veglat dhe për to mbanë evidencë,
- Kujdeset për evidencën e lëndimeve në punë dhe të sëmundjeve, që kanë të bëjnë me kushtet e punës së punëtorëve,
- Përgatitë dhe teston në funksionimin e gypave të zjarrfikëseve nga kutia shpërndarëse dhe nga kutia deri në hapësirat e caktuara.  
Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit të Sektorit

#### **Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare (përparësi fakulteti i Sigurisë, certifikimi në këtë lami etj.)
- Përvojë pune së paku 3 vite profesionale është përparësi;
- Njohuri të mira rreth ligjeve në fuqi që lidhen me natyrën e punës;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft (Word, Excel, Outlook) Internet.

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

##### **Dokumentacioni i kërkuar:**

- Kandidati/ja, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com);
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojës së punës;
- Kopje të Certifikatave të tjera nëse ka kandidati

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.



### Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë punëtorët e rregullt të NPK "Trafiku Urban" SHA.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **03.06.2020** dhe përfundon më datë **17.06.2020** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:  
02.06.2020

